



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 10
29.04.2014

NR. VENDIMI 7
30.04.2014

V E N D I M
“PER SEKUESTRIMIN E PASURISE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtar : Klodian KURUSHI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ermira TERBUNI**, sot më **datë 30. 04. 2014, ora 13. 00**, zhvilloi gjykimin e kerkeses penale qe i perket;

KERKUES : Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, perfaqesuar nga **prokurori Edvin Kondili**.

KUNDER : **1.I.M.**, i biri i S. dhe i F., i datelindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, xxx.Zhvilluar gjykimi ne mungese te tij.
2.H.R., i biri i B. dhe i S., i datelindjes xxx, lindur dhe banues ne xxx, xxx. Zhvilluar gjykimi ne mungese te tij.

OBJEKTI : Sekuestrimin e pasurive te luajtshme te shtetasve I.M. dhe H.R. si më poshtme:

- a) Nje shume monetare prej xxx leke, qe ndodhet ne Banken xxx, ne llogarine me nr. xxx.
- b) Nje shume monetare ne euro prej xxx, qe ndodhet ne Banken xxx, ne llogarine me nr. xxx.

- c) Nje automjet i tipit xxx me ngjyre te zeze, me targa xxx, se bashku me celesat, qe ndodhet ne ambientet e Drejtorise se Policise Qarkut Tirane.
- d) Nje automjet i tipit xxx, me ngjyre te xxx, me targa xxx, se bashku me celesat qe ndodhet ne Ambientet e Drejtorise se Policise Qarkut Tirane.
- f) Per Administrimin e kesaj **e pasurie** të ngarkohet **z.K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- g) Per ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarrimit xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjoi në diskutimin përfundimtar prokurorin i cili kërkoi:

-Sekuestrimin e pasurive sipas objektit te kerkeses, për administrimin dhe përdorimin **e pasurive** të ngarkohet **z.K.Xh.**, i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë si dhe, për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarrimit xxx;

V Ë R E N:

Prokuroria per Krime te Renda Tirane me date xxx ka regjistruar procedimin pasuror nr. xx te vitit xxx ne ngarkim te shtetasve I.M. dhe H.R.

Ne ngarkim te ketyre shtetasve me date xxx nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësore xxx, ka filluar procedimi penal nr. xxx, i vitit xxx, pasi dyshohen te kene kryer vepren penale të “Prodhimit dhe shitjes se narkotikeve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal.

Me date xxx, jane arrestuar ne flagrante shtetasit I.M. dhe H.R., pasi atyre u eshte gjetur dhe sekuestruar ne cilesine e proves materiale nje sasi lende narkotike e llojit kokaine me peshe xxx gram. Shtetasit I.M. i jane gjetur dhe sekuestruar ne funksion te procedimit penal nje shume monetare prej xxx leke llogari bankare, nje shume ne euro prej xxx llogari bankare, nje automjet e tipit xxx, me ngjyre te zeze, me targa xxx, se bashku me celesat. Shtetasit H.R. i jane gjetur dhe sekuestruar nje automjet tip xxx, me ngjyre gri me targa xxx, se bashku me celesat.

Me shkresen nr. xxx Prot, date xxx te Prokurorisë së Rrethit Gjyqësore xxx rezulton se automjetet e sekuestruara ndodhen ne ambjentet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, ndërsa shumat monetare gjenden pranë bankës xxx, ku përkatësisht shuma prej xxx lekë ne llogarinë me nr. xxx, ndërsa shuma në euro prej xxx në llogarinë me nr. xxx. Për këto shuma monetare si dhe automjete ekziston një rrezik real dhe potencial qe këto sende të tjetersohen ose të humbasin në rast të shfuqizimit të sekuestros vendosur në funksion të procedimi penal të filluar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor xxx.

Gjykata referuar akteve përkatëse, konstaton në te tilla rrethana se shtetasit I.M. dhe H.R., janë subjekt të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, konkretisht sipas nenit 3/1 pikat *“ç”* dhe *“d”*, pasi të dy këta shtetas rezultojnë të jenë persona nën hetim për veprat penale të cilat është parashikuar fusha e zbatimit të këtij ligji.

Nga sa me siper rezultoi nga aktet e provat shkresore, sa vijon;

-Urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë xxx, referim për fillimin e procedimit pasuror ndaj shtetasit I.M., datë xxx, urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë xxx të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, Informacion për referimin e veprës penale, datë xxx, procesverbal i kapjes në flagrancë datë xxx, procesverbal i kontrollit të vendeve datë xxx, vendim për vleftësimin e kontrollit të vendeve, datë xxx, procesverbal për arrestimin në flagrancë të

shtetasit H.R., date xxx, procesverbal i kontrollit të shtetasit H.R. datë xxx, procesverbal për sekuestrimin e provave materiale datë xxx, vendim për vleftësimin e sekuestros datë xxx, procesverbal mbi deklarimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime të shtetasit H.R., datë xxx, procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit I.M. datë xxx, procesverbal i kontrollit personal të shtetasit I.M. datë xxx, procesverbal për sekuestrimin e sendeve të provave materiale shtetasit I.M. dhe H.R., vendim për vleftësimin e sekuestros datë xxx, procesverbal mbi sekuestrimin e provave materiale datë xxx, procesverbal mbi deklarimin e personit ndaj të cilit zhvillohet hetime të shtetasit I.M. datë xxx, procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale datë xxx, procesverbal për sekuestrimin e provave materiale lëndës narkotike shtetasve I.M. dhe H.R., procesverbal për përshkrimin dhe peshimin e lëndës narkotike të sekuestruar shtetasve I.M. dhe H.R., vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopikë datë xxx, vendim për kryerjen e ekspertimit kimik të lëndës pluhur të sekuestruar shtetasve I.M. dhe H.R., kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, shkurtim vendimi nr. xxx dhe xxx akti e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, procesverbal i lënies në ruajtje të automjetit tip xxx i shtetasit H.R., datë xxx, procesverbal i lënies në ruajtje të automjetit tip xxx model xx i shtetasit I.M., akt ekspertimi vlerësues i provave materiale, nr. xxx datë xxx të paraqitura nga organi i prokurorisë në seancë gjyqësore.

Bazuar në rrethanat dhe prova të mesipërme, gjykata çmon se kërkesa e akuzës për sekuestrimin e pasurive të kërkuara nga ana e saj gjendet e bazuar në ligj dhe do të pranohet, pasi personat që disponojnë këto pasuri, po hetohen për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe natyra e kësaj vepre penale krijon indicje të mbështetur në provat e përmendura më lart, se ato janë krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën transaksioneve që lidhen me narkotikët.

Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata konkludon se duke u bazuar në provat e shqyrtuara dhe të analizuara më lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje se, personat ndaj të cilëve është paraqitur kërkesa për sekuestrimin e sendeve, janë përfshirë në veprimtari kriminale, nga ato që parashikon pika 1 e

nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009. Ata zotërojnë pasuri të përshkruara më lart të cilat dyshohet se rrjedhin nga kjo veprimtari e kunderligjshme për të cilën ata po hetohen.

Nga provat e shqyrtuara gjykata çmon se ekziston një rrezik real për humbje, marrje, transferim apo tjetërsim të pasurive, ndaj të cilave mund të zbatohet në të ardhmen masa e konfiskimit, në qofte se këto pasuri nuk do të sekuestroheshin nga kjo gjykate, ne perputhje me procedurat e parashikuara nga ky ligj.

Sendet e kërkuara nga për sekuestrim janë gjithashtu të sekuestruara nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë për llogari të procedimit penal të nisur prej saj ndaj të dy personave. Bazuar në nenin 5/3 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masa Parandaluese kundër Pasurisë”* gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros për sa kohë këto sende qëndrojnë të sekuestruara me një vendim të marrë për llogari të një procedimi penal të nisur nga Prokuroria e rrethit gjyqësor xxx. Nëse në të ardhmen gjykata penale do të marrë një vendim penal për revokimin apo shuarjen e masave të sekuestros atëherë pezullimi i masës së sekuestros i dhënë në këtë vendim civil përfundon dhe sekuestrimi i sendeve rivendoset menjëherë sipas këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 3, 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*,

V E N D O S I

- Sekuestrimin e pasurive të shtetasve I.M. dhe H.R. si më poshtme:
 - a) Një shumë monetare prej xxx (xxx) lekë që ndodhet në Bankën xxx, në llogarinë me nr. xxx.
 - b) Një shumë monetare në euro prej xxx (xxx) që ndodhet në Bankën xxx, në llogarinë me nr. xxx.

c) Nje automjet i tipit xxx me ngjyrë te zezë, me targa xxx, së bashku me çelesat, që ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxx.

d) Nje automjet i tipit xxx me ngjyrë gri, me targa xxx, së bashku me çelesat që ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxx.

f) Per Administrimin e kesaj e pasurie të ngarkohet **z. K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

g) Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx.

- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes për palen e pranishme, ndersa për palët në mungese, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni për vendimin.

U shpall në Tiranë më datë 30. 04. 2014.

SEKRETARE

Ermira TERBUNI

GJYQTARI

Klodian KURUSHI